

Në datën **28.03.1998**, Muja me bashkëshorten Vasen ishin vetë në shtëpi. Pjesëtarë të tjerë të familjes e kishin braktisur fshatin. Në çastin kur ishte brenda në shtëpi, Vasa ka dëgjuar përnjëherë britmat dhe të shtënat nga oborri. Doli dhe e vërejtí Musën të shtrirë në tokë [**Vojníkë/Voçnjak**]. Kur iu afrua, ka vërejtur se ai ishte plagosur në disa vende. Musa ka ndërruar jetë në agimin e ditës tjetër. Në mëngjesin e njëjtë, djali i tij Lutfiu me miqtë e kanë varrosur Mujën në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata V.A, FDH-40641; J. Osmani, *Krimet...*, II, 289.

### **Bajram (Jashar) Berisha**

(5.03.1947, shqiptar nga Zabërgja/Zabrde, komuna e Klinës/Klina, auto-transportues, shtatë fëmijë)

### **Salih (Jashar) Berisha**

(19.12.1948, shqiptar nga Zabërgja/Zabrde, komuna e Klinës/Klina, pronar i pikës së karburanteve *Naseri*, dy fëmijë)

### **Brahim (Selim) Salihaj**

(8.06.1950, shqiptar nga Zabërgja/Zabrde, komuna e Klinës/Klina, punëtor ndërtime, katër fëmijë)

### **Brahim (Halil) Zogaj**

(12.12.1940, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, pylltar, nëntë fëmijë)

### **Ramadan (Brahim) Zogaj**

(24.03.1958, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, automekanik, gjashtë fëmijë)

### **Fadil (Brahim) Zogaj**

(4.04.1971, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, automekanik, i pamartuar)

Bajram Berisha me bashkëshorten dhe shtatë fëmijë jetonin në Zabërgjë/Zabrde [Klinë/Klina]. Në muajin mars të vitit 1998, te ai kanë ardhur i vëllai Salihu me familje. Ata e kishin braktisur Gllarevën/Iglarevo. Salihu ishte pronar i pikës së karburanteve në Gllarevë/Iglarevo [Klinë/Klina], e cila gjendej në afërsi të rrugës Prishtinë/Priština – Pejë/Peć. Në datën 2.04.1998, rreth orës 22:00, një grup i burrave të armatosur, të veshur në uniforma dhe me

maskat në kokë, pjesëtarët e të cilit flisnin shqip, erdhën te shtëpia e Bajramit. E morën Salihun me djalin Naserin dhe Bajramin me djemtë Xhemën dhe Bislimin. I futën në një furgon të tipit *Wolkswagen* dhe i çuan në shtabin e UÇK-së në Likoc/Likovac. Atje i keqtrajtuuan fizikisht. Pastaj, i kthyen në furgon dhe i bartën në drejtim të fshatit Murgë/Murga [Skënderaj/Srbica], ku u liruan Xhema, Bislimi dhe Naseri. Ishte kjo hera e fundit kur ata i panë të gjallë Bajramin dhe Salihun.

Në të njëjtën mbrëmje, një grup i personave të maskuar e ka marr edhe Brahim Salihajn nga shtëpia e tij në Gllarevë/Iglarevo, ku jetonte me bashkëshorten Nazilen dhe katër fëmijë. E kanë futur në furgonin e tipit *Wolkswagen* dhe e kanë çuar në drejtim të Likocit/Likovac.

Brahim Zogajn dhe tre djemtë e tij, Ramadanin, Fadilin dhe Tefikun, personat e maskuar i kanë nxjerrë nga shtëpia familjare në Gllarevë/Iglarevo. Tefikun e liruan më vonë, ndërkaq Brahimin, Ramadanin dhe Fadilin i çuan më këmbë deri te varrezat në Zabërgjë/Zabrde, nga ky me furgonin e tipit *Wolkswagen* i bartën në drejtim të panjohur. Vëllezërit Bajram dhe Salih Berisha, Brahim Salihaj, Brahim Zogaj dhe djemtë e tij, Ramadani dhe Fadili, mbaheshin në mend të shiheshin për herë të fundit të gjallë pasmesnate, më **3.04.1998**, në shtabin e UÇK-së në **Likoc/Likovac**.

Trupat e pajetë të vëllezërve Bajram dhe Salih Berishes, si dhe të Brahim Salihajt, Brahim Zogajt dhe djemve të tij, Ramadanit dhe Fadilit, u gjetën në afërsi të Rahovecit/Orahovac, te vendi i quajtur *Te Rrasat/Ploçe*. Në trupat e tyre u konstatuan gjurmët e dhunës në formë të frakturës të së kockave dhe hematomave. Ishin të ekzekutuar me armë zjarri. Në datën 7.04.1998, familjet i kanë marrë dhe i kanë varrosur trupat e të vvarëve. Bajram dhe Salih Berisha, si dhe Brahim Salihaj, u varrosën në varrezat e Zabërgjës/Zabrde, përderisa Brahim Zogaj me djemtë Ramadanin dhe Fadilin, u varrosën po atë ditë në varrezat e Gllarevës/Iglarevo.

**Burimet:** deklarata T.Z, FDH-35410; deklarata